



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 12716/7956/3146 (31025-01974-86-2016) Akti

Tiranë me 04.12.2018

NJOFTIM ME SHPALLJE

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, është regjistruar çështja administrative me palë:

PADITËS: **Agim Velaj**, i biri Fejzos dhe i Erveles i dtl. 10.05.1956, lindur në Klos dhe banues në Vlorë, lagje "Isa Boletini", nr. S'ka, shtëpi pranë Konviktit të Universitetit "Ismail Qemali" të qytetit të Vlorës.

I PADITUR: **Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë**

OBJEKTI: Kundërshtimin anullimin e aktit administrativ (Kthim përgjigje) Nr. 8569 prot datë 30.12.2013 ju bëjmë me dijeni se nuk ju pajisin me certifikatë pronësie për pasurinë Nr. 2/25-nd të regjistruar në volumnin 9 faqe-187, lloj pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 64 metra katror pasi kjo pasuri figuron e regjistruar por kompania e menaxhimit e ka cilësuar pronar i pavërtetuar. Detyrimin e ZRPP Vlorë të pajise pronarin Agim Velaj me certifikatë pronësie për pasurinë e regjistruar me Nr. 2/25-ND vol. 9 faq 187, lloji i pasurisë ndërtesë me sipërfaqe 64 m2 e ndodhur në zonën kadastrale nr. 85602 të lagjia "Isa Boletini" në Qytetin e Vlorës.

BAZA LIGJORE: Në bazë të nenit 15/a, 16, 17.f.b.c, 40/1/a/c i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatën administrative", Neni 31, 32, 43/2, 154 e vijues K.Pr.Civile neni 15/a, 16, 17/b,c, 40/1/a,c i ligjit nr. 49/2012 "Gjykatës administrative" e ligji ndryshuar nr. 7843 datë 13.07.1994, Nr. 8090 datë 21.03.1996, Ligji nr. 33/2012 neni 28, 38 "Mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme", neni 192-193 K.Civil.

Bazuar ne nenin 133 të K.Pr.Civile, njoftohet me anë të kësaj shpallje palën paditëse në këtë gjykim **Agim Velaj** se me **datë 15.01.2019, ora 09:30** në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë do të zhvillohet seanca gjyqësore për gjykimin e çështjes me palë dhe objekt si më sipër.

Kopje të kësaj shpallje të vendosen në Bashkinë Vlorë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në faqen e Web www.gjykataadministrativeapelit.al, si dhe një kopje të depozitohet në dosjen gjyqësore.

GJYQTARE
Bermina KONDI